

Garancia e 3-fishtë

- Rezistenca ndaj konsumimit
- Fortësia e dritës
- Rezistenca ndaj njollave

Raportet në lidhje me pretendimet kontraktuale dhe ligjore për defektet

Me këtë garanci kompania Kronoflooring GmbH (në vijim e përmendur edhe si „Kronoflooring“) i jep blerësit të drejta shtesë, krahas të drejtave për pretendime kontraktuale dhe ligjore në raste defektesh. Me rregullat e bashkangjitura në vijim çdo modifikim, kufizim apo ndryshim tjetër nuk është i lidhur me pretendimet kontraktuale dhe ligjore. Blerësi i parë në këtë garanci, është ai që ka blerë parketin laminat si konsumator i parë nga një tregtar

Kushtet e garancisë

Kjo garanci është e vlefshme **për shtëpitë private** për të gjitha dyshemetë laminat që i nënshtrohen kushteve normale të përdorimit bazuar në klasën e rekomanduar të shërbimit sipas normës EN 13329, por jo atyre që i nënshtrohen stresit kimik ose mekanik. Garancia nuk është e transferueshme, ajo vlen vetëm për blerësin e parë.

Koha e garancisë

Periudha e garancisë varet nga produkti përkatës dhe tregohet në paketimin e produktit. Koha e garancisë fillon me datën e faturës origjinale të paraqitur nga blerësi i parë. Në varësi të shërbimit të garancisë, koha e garancisë as nuk zgjatet, dhe as nuk rinovohet.

Shtrimi

Dyshemetë me laminat duhet të shtrohen në përputhje me udhëzuesin për shtrim. Udhëzimet për shtrim gjenden në çdo paketë, një udhëzues të detajuar për shtrimin e gjenin në faqen e internetit www.laminat-installation.com.

Trajtimi

Garancia nuk do të zbatohet, nëse në hapësirat ku shkelet, nuk vendosen tapete mbrojtës ose kur shfaqen mangësi si shkak i konsumit natyror, trajtim, ndarje, përdorim apo depozitim jo profesional apo në raste ndryshimesh jo profesionale apo riparime të pasakta si dhe kur gjatë shtrimit nuk janë përdorur pajisjet origjinale të Kronoflooring.

Rezistenca ndaj konsumimit

Një pretendim për mbulim nga garancia aplikohet vetëm në rast se shtresa dekoruese është me distancë të paktën prej një centimetri katror. Konsumi i shfaqur në cepat e paneleve nuk përfshihen në garanci.

Fortësia e dritës

Fortësia e dritës sipas gradës 6 të shkallës matëse të leshtit blu. Testimi është bërë në përputhje me EN 20105. Këtu përjashtohet vjetërimi natyror

Rezistenca ndaj njollave

Nën efektin e substancave si : aceton, krem duarsh, pije alkoolike, lëng frutash dhe perimesh, yndyra, kafe, pije coca-cola, manekyr.

Rimbursimi i një kërkesë për garanci

Çdo ankim duhet të paraqitet me shkrim bashkë me fletë garancinë e plotësuar dhe faturën origjinale të blerjes. Kërkesa për aplikim të garancisë duhet të zbatohet brenda 30 ditëve nga shfaqja e defektit. Para identifikimit të ankesës, ne mbajmë të rezervuar të drejtën për të parë defektin në vend ose për të deleguar persona të tretë për këtë.

Shërbimi i garancisë

Kronoflooring mund të rimbursojë garancinë ndaj blerësit të parë sipas zgjedhjes së vet në para ose duke zëvendësuar dëmin. Shërbimi i garancisë në para i referohet vetëm vlerës në atë kohë të mallit. Pretendime të tjera për shërbimin e garancisë nuk ekzistojnë. Shërbimet e garancisë nuk përfshijnë veçanërisht çmontimin, montimin, transportin dhe kostot e udhëtimit si dhe kostot e depozitimit dhe të transportit. Nëse parketi laminat nuk ekziston më në shitje në dekorin e dëshiruar, atëherë duhet të zgjidni nga sortimentet aktuale.

Ligji në fuqi

Vlen e drejta gjermane duke përjashtuar Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG).

Ne jemi në dispozicion për ju 3 here, garancia e trefishtë.

3x
Garancia

Ju lutem plotesoni:

Emri:

Rruga:

Qyteti:

Telefoni: Tele-faks:







Email:

Ne cilat ambiente është shtrire produkti yne?

- Dhome e gjumit Dhume e ngrënjes Lloji i dekorit:
- Dhome për femije Dhume për zbatimje Numri i dekorit:
- Dhome për ndejtje Ose perndryshe:
- Guzhine Sasia e produktit:
- Korridor

Dekori?

Ne cilen kategori hyn menyra e përdorimit të produktit?

-  Ambientet për ndejtje me përdorim të rrallë
-  Ambientet pune me përdorim të rrallë
-  Ambientet për ndejtje me përdorim të mesëm
-  Ambientet pune me përdorim të mesëm
-  Ambientet për ndejtje me përdorim të intensiv
-  Ambientet pune me përdorim të intensiv